

**KËSHILLI I NDERIT PRANË SHOQATËS SË GAZETARËVE TË MAQEDONISË , SHGM**, në seancën e mbajtur më 20.04.2023, duke vepruar pas parashtrësës së dorëzuar nga Ardit Ramadani, gazetar i TV Alsat-M, kundër Liridona Vejselit nga portali “Pa Censurë”, e solli këtë

#### VENDIM

- 1. PARASHTRESA E ARDIT RAMADANIT PRANOHEТ, DHE KONSTATOHET SHKELJE E PORTALIT “PA CENSURË”.**

#### ARSYETIM

Ardit Ramadani nga TV Alsat-M, dorëzoi parashtrësë kundër raportimit të gazetares Liridona Vejseli nga portali në gjuhën shqipe “Pa Censurë”, në të cilin ka vendosur një raportim për zhdukjen e dy vajzave të mitura në Shkup. Në tekst gazetarja mes arsyeve të arratisjes së fëmijëve ka shkruar edhe faktin se ata para dy javësh i kanë zbuluar “ndjenjat e ndërsjella para drejtorisë së shkollës”. Sipas parashtruesit, është aluduar në orientimin seksual të vajzave gjë që është shkelje e dinjitetit të tyre.

Njëkohësisht, ishin publikuar edhe fotografi të vajzave, si nga portali ashtu edhe në profilin e Fejsbukut të gazetares.

Këshilli i Nderit konstaton se Kodeksi i Gazetarëve të Maqedonisë në nenin 9 ndalon : gazetari të fotografojë apo intervistojë fëmijë nën moshën 16 vjeçare, pa lejen e prindërit apo kujdestarit, përveç nëse kjo ka të bëjë me të drejtat e fëmijës.

Neni 7 nga ana tjetër e rregullon faktin se gazetari do ta respektojë privatësinë e personit.

Në rastin konkret, Këshilli i Nderit ka konstatuar se janë publikuar fotografi të fëmijëve në të cilat nuk është vendosur asnjë mbrojtje, ndërsa me tekstin, edhe pse në mënyrë eksplicite nuk është folur për orientimin e tyre seksual, siç ka theksuar parashtruesi, ka ndërhyrje në arsyet spekuluese që nuk mund të bien në kategorinë e “interesit publik” apo “të drejtave të fëmijëve”, prandaj, parashtrësja është e BAZUAR.

Këshilli i Nderit konstatoi se njoftimi i publikuar më vonë ishte larguar, por kujton se gazetarët duhet të jenë të vëmendshëm kur raportojnë për tema të ndjeshme, pasi që dëmin që mund ta shkaktojnë me informacionet e publikuara mund të jetë shumë i madh.

Privatësia e personave dhe ndjenjave të tyre (pavarësisht nëse janë fetare, religjioze, të dashurisë) nuk janë lëndë e interesit publik dhe ato nuk duhet të sillen në korrelacion me një ngjarje si kjo, zhdukje, nëse nuk ka prova të forta për një gjë të tillë.

Vendosur në Shkup, më 20.4.2023

KËSHILLI I NDERIT PRANË SHGM

Kryetar i Këshillit

Sashe Dimovski

